

L I G J
Nr.8508, datë 7.7.1999

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8435, DATË 28.12.1998 “PËR
SISTEMIN E TAKSAVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe të nenit 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8435, datë 28.12.1998 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë” bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në lidhjen nr.2 “Taksat për shërbimet konsullore”, në pikën I “Taksat për lëshimin e vizave dhe dokumenteve të udhëtimit” shtohen pikat 6/1, 7/1 dhe 8 me këtë përmbajtje:

“6/1. Taksa e vizës për shtetasit e huaj që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë me grupe turistike nëpërmjet shoqërive turistike10 USD”

“7/1. Taksa e hyrjes së shtetasve të huaj që nuk kanë nevojë për vizë dhe që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë me grupe turistike nëpërmjet shoqërive turistike 10 USD”

“8. Grupet turistike me shtetas të shteteve që, sipas parimit të reciprocitetit, nuk paguajnë taksë vize ose taksë hyrje, nuk i nënshtrohen taksave të përmendura në pikat 6/1 dhe 7/1.”

Neni 2

Në nenin 12 paragrafi i parë, fjalët “nenin 10” zëvendësohen me fjalët “nenin 11”.

Neni 3

Në lidhjen nr.6 “Taksat për veprimet dhe shërbimet që kryhen nga administrata gjyqësore e Ministria e Drejtësisë, noteria dhe zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, prokuroria dhe zyrat e gjendjes civile”, pikat “c” dhe “d” ndryshohen sipas lidhjes e cila i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.2418, datë 19.7.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

- C. Taksat për veprimet që kryhen nga zyrat noteriale
1. Përpilimi i testamenteve me akte noteriale 450
 2. Përpilimi i testamenteve ollografe (me vërtetim firme) 200
 3. Prokura (redaktim)
 - të përgjithshme 150
 - të posaçme 150
 4. Për lëshimin e kopjeve, shkurtime e pjesë të akteve të depozituara në zyrën noteriale 150

5. Vërtetim se kopjet ose shkurtime të dokumenteve janë të njëjta me origjinalin 150
6. Vërtetim përkthimi dhe vërtetim njësisë me origjinalin 100
7. Kontrata për kalim pronësie të pasurisë së luajtshme 700
8. Kontrata për kalim pronësie të pasurisë së paluajtshme 1000
9. Redaktimi i akteve noteriale të ndryshme 150
10. Njoftim dhe kujtesë noteriale ose akte të tjera jashtë gjyqësore 150
11. Legalizim i nënshkrimit të shtetasve në akte të ndryshme 100
12. Depozitimi i kapitalit themelor për themelimin e një shoqërie në bazë të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare” 300
13. Pranimi për ruajtje të dokumenteve të personave fizikë dhe juridikë në zyrat noteriale 300
14. Vërtetimi i qënies së një personi dhe qëndrimi i tij në një vend të caktuar 150
15. Veprime të tjera noteriale 100

D. Taksat për veprimet që kryhen nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme

1. Kërkesa për regjistrimin e pronësisë së pasurisë të paluajtshme 300
2. Kërkesa për regjistrimin e pjesëtimit, ndarjes ose bashkimit të pasurisë së paluajtshme 300
3. Kërkesa për përgatitjen e dokumenteve për në gjykatë ose organ tjetër administrativ 150
4. Kërkesa për regjistrimin për kalim pronësie, qiraje, nënqiraje 300
5. Kërkesa për regjistrim hipoteke ligjore 150
6. Kërkesa për regjistrim përfshirje hipoteke ligjore 150
7. Kërkesa për regjistrim përfshirjen e një vendimi gjykatë a të një akti administrativ 150
8. Kërkesa për regjistrim servituti, marrëveshjeje kufizuese 150
9. Kërkesa për regjistrim për fshirjen e një servituti, marrëveshjeje kufizuese 150
10. Regjistrimi i kërkesave për heqjen dorë nga të drejtat pasurore mbi pasurinë e paluajtshme 100
11. Regjistrimi i kërkesave për fitimin e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme me trashëgimi 300
12. Kërkesa për regjistrimin e veprimeve juridike mbi pasurinë e paluajtshme nga personat fizikë dhe juridikë me banim jashtë shtetit 300
13. Për lëshimin e certifikatave të pasurisë 100
14. Për lëshimin e çdo kopjeje të certifikatës së pasurisë 50
15. Për lëshimin e çdo akti të interesuarve për veprimet hipotekore 50